



## Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 27.08.2018

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 27.08.2018 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Ulpiana" për aktivitetin: "**Rikonstruimi i rruges Eqrem Qabej nga udhekryqi i Katerdrales deri tek Udhekryqi i Mensese se studenteve si dhe rikonstruimi i rrugës Shkodra,Raim Kiçina dhe Fan Noli ne lagjenTasligje**" dhe me numër të prokurimit: 616 -18-071-521 nxjerr:

### V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "**Ulpiana**" e datës 27.08.2018 lidhur me aktivitetin e prokurimit: "**Rikonstruimi i rruges Eqrem Qabej nga udhekryqi i Katerdrales deri tek Udhekryqi i Mensese se studenteve si dhe rikonstruimi i rrugës Shkodra,Raim Kiçina dhe Fan Noli ne lagjenTasligje**" me Nr.616 18 4313 521 Nr. Brendshëm 616 18 071 521 kundër *Vendimit për dhënje të kontratës* të AK -së, të datës 22.08.2018, të publikuar në web-faqe të KRPP-së.
2. Aprovohet vendimi për dhënje të kontratës i publikuar me datë: 22.08.2018;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin sipas publikimit të datës 22.08.2018.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

### A r s y e t i m


Operatori Ekonomik "**Ulpiana**" me datë 27.08.2018 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "**Rikonstruimi i rruges Eqrem Qabej nga udhekryqi i Katerdrales deri tek Udhekryqi i Mensese se studenteve si dhe rikonstruimi i rrugës Shkodra,Raim Kiçina dhe Fan Noli ne lagjen Tasligje**" me numër të prokurimit Nr.616 18 4313 521 dhe numër të brendshëm 616 18 071 521.

Autoriteti Kontraktues, me datë 27.08.2018, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

- OE-ik "Ulpiana" sqarimet lidhur me bazen e asfaltit i ka derguar pas skadimit te afateve ligjore (2 dite nga pranimi i kerkeses), pasi qe kerkesa i eshte derguar me daten 19.07.2018, dhe afati i dorezimit ka qene 2 dite ndersa sqarimet lidhur me kete tenderuesi i ka derguar me date 31.07.2018 . Ne te njejten leter standarde te kerkeses per sqarim te tenderit e cila ju ka derguar ,citet se pa pergjigjen nga ana juaj ne pyetjet e larte shenuara brenda afatit kohor te larte shenuar ( brenda 2 diteve nga data e kerkeses ) , tenderi juaj do te refuzohet.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimit te ketij vendimi.



Zyrtari përgjegjës i Prokurimit